

KONTRATË**ANËTARËSIMI NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR RAIFFEISEN
(Për Individin)****Informacion mbi Anëtarin në Fond**

Emër Atësia Mbiemër....., Shtetësia....., Numri personal(bashkëlidhur kopje e dok. të identifikimit), Datëlindja __/__/__, Vendlindja....., Vendbanimi i përhershëm/përkohshëm....., Adresa....., Kodi Postar....., Tel/Cel....., e-mail, Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj)....., i punësuar në, adresa e punëdhënesit

Informacion mbi Fondin

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen, i administruar nga Raiffeisen Invest- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, në monedhën lekë, i miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimet nr.107 datë 18.10.2010 dhe nr. 66, datë 29.04.2025;

Informacion mbi Shoqërinë Administruese

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh. a, e krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, themeluar dhe regjistruar si person juridik më datë 18.07.2005, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Licencë nr.1 datë 13.12.2011 si dhe Vendimet nr.179 datë 13.12.2011, nr. 9, datë 31.01.2022 , nr.66, datë 29.04.2025, me NUIS K51928001I, me seli dhe zyra qendrore në adresën: Rr.Abdyl Frashëri, EGT Tower, Kati 3-të Tiranë, përfaqësuar nga Administratorë Ekzekutivë/ose Agjenti shitës i Autorizuar Raiffeisen Bank sh.a, me NUIS J61911005B, me seli në adresën: Rr.e Kavajës, Tiranë;

Informacion mbi personin e tretë që derdh kontribute në emër dhe për llogari të Anëtarit (person juridik)

Emri i personit juridik.....Selia.....NUISPersoni i autorizuar për përfaqësim(bashk. dok. identifikues), personi i kontaktit:Telefon.....Nënshkrimi dhe vula.....

Informacion mbi personin e tretë që derdh kontribute në emër dhe për llogari të Anëtarit (person fizik)

Emër Atësia Mbiemër....., Shtetësia....., Numri personal.....(bashkëlidhur kopje e dok. të identifikimit), Datëlindja __/__/__, Vendlindja....., Adresa....., Kodi Postar....., Tel....., e-mail, Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj), i punësuar në....., adresa....., e punëdhënesit....., Nënshkrimi.....

Vlera e kontributit:lekë (.....).Frekuenca e pagesës:

(Burimi i të ardhurave.....)

Deklaratë e Anëtarit në Fond

Deklaroj se kam kuptuar dhe pranuar kushtet e kontratës, kam marrë përsipër rrezikun e mundshëm të investimit, tarifat që aplikohen, si dhe përmbajtjen e prospektit si dhe konfirmoj se kam marrë një kopje të Prospektit.

Konfirmoj nën përgjegjësinë time se investimi i kontributeve, do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme dhe njëkohësisht burimi i tyre është nga një aktivitet i ligjshëm.

Kuptoj se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë kontratë/ose në çdo dokument tjetër të nënshkruar apo deklaruar pranë Raiffeisen Invest sh.a, janë të dhëna të detyrueshme, të cilat do të përpunohen nga kjo e fundit me standartet me të larta të sigurisë si dhe konform parashikimeve ligjore në fuqi, vetëm për qëllimin e ofrimit të produkteve/ dhe/ose për të përmbushur një detyrim ligjor që Raiffeisen Invest sh.a mund të ketë, bazuar në aktet ligjore dhe rregullative në Republikën e Shqipërisë. Kuptoj se mbetet detyrim i imi të përditësoj këto të dhëna, sa herë që do të ndryshohen. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me faktin se kam të drejtë, që në çdo kohë, me anë të një kërkesë paraprake me shkrim, t'i kërkoj Raiffeisen Invest sh.a, që të korrigjojë apo të fshijë të dhënat e mia personale.

Përpunimi i të dhënave personale

Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë kontratë është i vërtetë dhe i saktë. Unë shpreh pëlqimin tim që Raiffeisen Invest sh.a, të mbledhë të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë kontratë, si edhe t'i përpunojë më tej ato vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit për të cilin po aplikoj. Kuptoj se, çdo e dhënë personale lidhur me

personin tim do të trajtohet me një nivel sigurie të standarteve më të larta në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, i cili zëvendësohet me Ligjin nr.124/2024"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si edhe në përputhje me parashikimet e bëra në "Rregulloren e Përgjithshme Europiane "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" GDPR.

Gjithashtu, deklaroj dhe jap miratimin tim për procesimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga ana e Raiffeisen Invest sh.a, duke i transferuar këto të dhëna drejt palëve kontraktore, të cilat mund të jenë në cilësinë e përpunuesit në kuadër, të çeljes, mirëmbajtjes dhe administrimit të llogarisë.

Në këtë kuadër, jepet në mënyrë të shprehur pëlqimi që Raiffeisen Invest sha, të mund të përcjellë çdo formë KYC, dhe të gjithë informacionin përfshirë në të, si dhe gjithë dokumentat që kam vënë në dispozicion për verifikim ose që i janë vënë në dispozicion RBI-së lidhur me procedurat KYC të saj, për marrësit e renditur më poshtë (Marrësit):

- anëtarë të grupit RBI në Austri ose brenda BE-së
- anëtarë të grupit RBI në vende të treta jashtë territorit të BE-së
- anëtarë të tjerë të Raiffeisen Banking Group

Çdo përcjellje e tillë do të kufizohet vetëm për marrësit me të cilët ka aktualisht një marrëdhënie biznesi ose që ka qëllim të lidhet një marrëdhënie biznesi.Kjo bëhet vetëm me qëllim përmbushjen e kërkesave KYC të marrësit pa u kërkuar të vëmë në dispozicion informacion dhe dokumentacion shumë herë.

Në këtë kuadër, jam njohur me faktin që të dhënat e mia personale i transferohen subjektit Banka e Parë e Investimeve-Albania sh.a, në cilësinë e Depozitarit të fondit bazuar në Ligjin nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit privat", si dhe subjektit Raiffeisen Bank sh.a Shqipëri & CRISP Centralised Raiffeisen International Services & Payments S.R.L me seli në Bukuresht- Rumani, në mënyrë që shoqëria të ushtrojë vigjilencën e duhur, si edhe të zbatojë detyrimet e tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare.

Autorizoj në mënyrë të shprehur Raiffeisen Invest sh.a, që të ruajë të dhënat e mia personale, për një afat deri në 11- vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes meje dhe shoqërisë. Jam njohur nga shoqëria me faktin që për çdo pyetje apo informacion lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave të mia personale, kam të drejtë të dërgoj e-mail në adresën elektronike: rba1.dataprotection@raiffeisen.al.

Gjithashtu, kuptoj se bazuar në dispozitat e GDPR dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, unë mund të ushtroj në çdo kohë të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale që përpunohen nga ana e Raiffeisen Invest sh.a. Gjithashtu, në çdo kohë ruaj të drejtën për t'u ankuar tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe ruaj të drejtën për t'u tërhequr nga dhënia e pëlqimit për përpunimin e të dhënave.

Anëtarë

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a

Miratimi për përpunimin e të dhënave personale në rast ofertash promionale

Jap miratimin tim të pakushtëzuar që Raiffeisen Invest sha, të përdorë të dhënat e mia personale për marketing direkt, informimin për fushata të ndryshme, me qëllimin e përfitimit nga ana ime të ofertave promionale, si pjesë e paketës së produkteve/shërbimeve që Shoqëria ofron(apo do të ofrojë në të ardhmen),nëpërmjet një ose disa prej kanaleve të informimit,duke përfshirë por pa u kufizuar në: i) postë zyrtare ii)sms iii)telefonatë iv) postë elektronike etj.

Deklaroj se jam venë në dijeni që dizenjimi i ofertave individuale do të bëhet nëpërmjet procesit të profilizimit që përfshin analizë të automatizuar të të dhënave personale për të konkluduar mbi nevojat ekonomike ose financiare, përgjegjësinë time financiare dhe karakteristika të tjera të cilat analizohen për të krijuar ofertat individuale.

Në këtë kuadër autorizoj Raiffeisen Invest sha, që duke respektuar standartet me të larta të sigurisë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të delegojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të mia personale, duke i transferuar këto të

dhëna tek palë të treta të specializuar për këtë qëllim. Në këtë kuadër, të dhënat e mia personale mund të përdoren dhe shkëmbehen edhe mes anëtarëve dhe partnerëve të grupit Raiffiesen brenda dhe jashtë vendit me qëllim që të më sigurojnë informacion lidhur me ofertat e tyre. Lista e tyre mund t'ju vihet në dispozicion bazuar në kërkesë. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me të drejtën që në çdo kohë të kërkoj nga Shoqëria revokimin e këtij miratimi.

☐ *Unë pranoj*

☐ *Unë nuk pranoj*

Data e lidhjes së kontratës.....

Vendi:

Anëtar

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a

përfaqësuar nga

Agjenti shitës i Autorizuar

Neni 1

OBJEKTI

Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve të ndërsjellta midis Anëtarit në Fond (në vijim Anëtari), dhe Raiffeisen INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a (në vijim Shoqëria Administruese), që rrjedhin nga anëtarësimi në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen (në vijim Fondi), me qëllim investimin e aktiveve dhe ofrimin e përfitimeve për pension, mbështetur në Ligjin Nr.76/2023 "Për Fondet e Pensionit Privat"(në vijim Ligji), aktet nënligjore në fuqi, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese.

Neni 2

BAZA LIGJORE

Kjo kontratë është bazuar në Ligjin nr. 76/2023 "Për fondet e Pensionit Privat", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 3

ANËTARËSIMI NË FOND

- 3.1 Çdo person mund të anëtarësohet në Fond duke lidhur një kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese.
- 3.2 Formulari standart i aplikimit, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate përfshin deklaratën personale të Anëtarit, i cili duke e nënshkruar pranon kushtet e kontratës, si dhe konfirmon se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht Prospektin e Fondit.
- 3.3 Shoqëria Administruese do të hapë një llogari personale për çdo Anëtar, sipas kontratës së lidhur.

Neni 4

PAGESA E KONTRIBUTEVE

- 4.1 Vlera e kontributit përcaktohet nga çdo anëtar, por jo më pak se 1000 (njëmijë) lekë në muaj.
- 4.2 Kontributet do të derdhen në llogarinë e Fondit nr.AL782151 1031 ALL 1 0000 0393 3000, pranë Bankës së Parë të Investimeve sh.a, Albania sh.a, e cila do të kryejë funksionin e Depozitarit të Fondit.
- 4.3 Anëtari mund të përcaktojë frekuencën e pagesës së kontributeve, por në çdo rast shuma do të jetë në përputhje me paragrafin 4.1 të këtij neni.
- 4.4 Aktivitetet e Anëtarit në Fond përbëhen nga kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të Anëtarit, dhe nga kthimi i investimit të bërë me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme, sipas dispozitave ligjore dhe kontratës.
- 4.5 Shoqëria Administruese konverton në kuotë pensioni, sipas çmimit të kuotës në ditën e pagesës së kontributit, kontributet e investuara në Fond dhe aktivitetet e transferuara nga një fond tjetër. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në aktivitetet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond, është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të Fondit.
- 4.6 Procedura e detajuar e konvertimit të kontributeve të paguara nga Anëtari në kuota, përcaktohet në prospektin e fondit, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- 4.7 Nëse Anëtari ndërpret pagesën e kontributeve, ai mbetet anëtar në Fond, dhe ka të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të Fondit. Shoqëria Administruese nuk aplikon asnjë penalitet në rast të ndërprerjes së pagesës së kontributeve nga Anëtari në fond;

Neni 5

POLITIKA E INVESTIMIT

- 5.1 Aktivitetet e Fondit do të investohen duke respektuar parimet e sigurisë afatgjatë, diversifikimit të portofolit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm, në kontekstin e arritjes të një kthimi të përshtatshëm dhe afatgjatë nga investimi, për sigurimin e aktiveve, dhe të ardhurave në moshën e pensionit, gjithmonë duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.
- 5.2 Fondi synon të ketë një portofol të përqëndruar, kryesisht në tituj borxhi afatgjatë të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Cash-i mund të mbahet në bankat dhe institucionet e tjera të mëdha financiare si depozitë afat shkurtër, ose transaksione të marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes me afat maturimi maksimumi deri në një vit, me qëllimin për të mbuluar nevojat e likuiditetit afatshkurtër të Fondit, duke përbushur edhe detyrimet ligjore ndaj anëtarëve brenda afateve të përcaktuara.
- 5.3 Për të arritur objektivat e tij afatgjatë, Fondi synon të implementojë kufijtë e mëposhtëm në lidhje me shpërndarjen e aktiveve të Fondit:

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE		
Instrumenti	Shpërndarja e synuar e aktiveve*	Maksimum
Tituj të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	95%	100%
Tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar.	0%	30%
Depozita bankare, marrëveshje të anasjellta të riblerjes, cash dhe ekuivalentë cash-i	5%	100%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar për tregtim në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend të OECD-së.	0%	100%
Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, me përjashtim të fondeve të investimeve alternative.	0%	30%

* Shpërndarja e synuar e aktiveve tregon se fokusi i investimit do të jetë në tituj borxhi të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Shpërndarja e synuar e aktiveve mund të ndryshojë në varësi të kushteve të tregut. Anëtarë në Fond duhet të ketë parasysh që shpërndarja e synuar e aktiveve është vetëm orientuese, dhe jo detyrues mund të arrihet. Kufizimet e shpërndarjes paraqesin kufij të sipërm, mbi të cilët Shoqëria Administruese nuk do të kryejë investime në një kategori të caktuar aktiveve.

- 5.4 Anëtarë pasi nënshkruan Deklaratën e pranimit të pjesëmarrjes, pranon kushtet e funksionimit të Fondit, Prospektin, dhe merr përsipër rrezikun e mundshëm të investimit të Fondit.

Neni 6

RREZIQET E INVESTIMIT

- 6.1 Investimi në Fond detyruesisht përfshin sipërmarrjen e rrezikut nga investitori. Rreziqet kryesore ndaj të cilave Fondi është i ekspozuar janë: rreziku i tregut, rreziku i kredisë, rreziku operacional, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit, rreziku ligjor, rreziku i agjencisë, rreziku reputacional.
- 6.2 Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë, përgjegjëse për evidentimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve që shoqërojnë investimet e kryera në emër të Fondit.
- 6.3 Anëtarë pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin e Fondit, merr përsipër rrezikun e investimit në Fond.

Neni 7

DEPOZITARI

- 7.1 Shoqëria Administruese ka lidhur një kontratë me Bankën e Parë të Investimeve, Albania sh.a, shoqëri aksionare e krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, themeluar dhe regjistruar si person juridik më datë 19.04.2006, që vepron si Bankë me licencën nr. 19, datë 06.07.2007 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me NUIS K72014801J, me seli në adresën Bul."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë, e cila në përputhje me ligjin Nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit privat", do të ofrojë shërbimet e Depozitarit për aktivet e Fondit.
- 7.2 Depozitari është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr.13, datë 10.03.2010, si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbimin e depozitarit për fondet e pensionit me Licencë nr. 1 datë 13.12.2011.
- 7.3 Depozitari është përgjegjës për ruajtjen e aktiveve të anëtarëve në Fond. Ai kontrollon administrimin e aktiveve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektit, si dhe të legjislacionit në fuqi.
- 7.4 Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese, dhe çdo palë tjetër e lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.

Neni 8

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese merr përsipër :

- Të administrojë me efektivitet aktivet e anëtarit në fond, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e aktiveve të anëtarëve. Në çdo rast performanca e fondit, dhe rrjedhimisht edhe vlera e investimit mund të luhet në varësi të kushteve të tregut.
- Të vërë në dispozicion të anëtarit Prospektin e Fondit, i cili përmban informacion të vërtetë dhe të saktë, raportet më të fundit vjetore dhe të ndërmjetme, si dhe pasqyrat financiare, sipas kërkesës dhe pa pagesë për fondin në administrim;
- Të ofrojë pensione dhe përfitime të tjera për anëtarin, sipas kushteve dhe procedurave ligjore;

- d) Të paktën 1 herë në vit, t'i vërë në dispozicion çdo anëtar, pa pagesë, në formë elektronike, vërtetimin për gjendjen e llogarisë së pensionit, i cili duhet të përmbajë informacion të saktë dhe të përditësuar mbi vlerën neto të aktiveve të akumuluar, kthimin nga investimi për periudhën 12-mujore, kontributet e derdhura nga anëtarit ose punëdhënësi në emër të anëtarit gjatë 12 muajve të fundit, dhe një detajim të kostove ose tarifave të zbritura nga shoqëria administruese;
- e) Të informojë anëtarët lidhur me mbarrëvajtjen e fondit të pensionit, nëpërmjet raportit mujor të publikuar në faqen zyrtare të shoqërisë administruese;
- f) Të sigurojë për çdo Anëtar mundësi kontrolli të gjendjes së llogarisë së tij/saj online, përfshirë informacionin mbi vlerën neto të aktiveve në Fond, datat e kontributeve, dhe transferimet e aktiveve të bëra nga ose në emër të Anëtarit gjatë periudhës përkatëse, dhe shndërrimin e këtyre kontributeve e të aktiveve në kuota të fondit;
- g) Të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo Anëtarit, dhe të japë informacion mbi aktivet vetëm tek Anëtarit në Fond, personat e autorizuar nga Anëtarit, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji;
- h) Të informojë në çdo kohë Anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikat e investimit, risqet që shoqërojnë investimin në fond, dhe çdo ndryshim thelbësor sipas dispozitave ligjore në fuqi, që mund të ketë efekt tek Anëtarët.
- i) Të kryejë transferimin e aktiveve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, si në rastin e transferimit në një Fond tjetër të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një Fond të administruar nga një tjetër Shoqëri Administruese.
- j) Të informojë 3 muaj përpara se anëtarit të arrijë moshën për pension, të drejtën për përdorimin e aktiveve neto në llogarinë e tij të pensionit, në lidhje me vlerësimin aktual të llogarisë individuale, ta pajisë me opsionet për mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe t'i japë udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë.

Neni 9

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

9.1. Anëtarit ka të drejtat e detyrimit e mëposhtme:

- a) Të ketë në çdo kohë pronësinë e aktiveve të investuara në Fond. Shoqëria administruese me kërkesë të anëtarit mundëson në çdo kohë dokumentin për pronësinë e kuotave në Fond, në përputhje me dispozitat ligjore.
- b) Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve, ose pagesat periodike në formë pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
- c) Të ketë mundësi kontrolli në çdo kohë të gjendjes së llogarisë së tij/saj online, përfshirë informacionin mbi vlerën neto të aktiveve në Fond, datat e kontributeve, dhe transferimet e aktiveve të bëra nga ose në emër të Anëtarit gjatë periudhës përkatëse, dhe shndërrimin e këtyre kontributeve e të aktiveve në kuota të fondit;
- d) Të transferojë aktivet e akumuluar në një Fond tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër Shoqëri Administruese;
- e) Të përfitojë nga lehtësitë tatimore, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi;
- f) Të ketë një fond pensioni të trashëgueshëm;

9.2 Gjithashtu, Anëtarit merr përsipër:

- a) Të përcaktojë shumën e kontributeve që do të paguajë, të ndryshojë këtë shumë, si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes së tij;
- b) Të informojë menjëherë dhe jo më vonë se 10 ditë, Shoqërinë Administruese lidhur me ndryshimet e kushteve që kanë të bëjnë me anëtarësimin në Fond;
- c) Të informojë Shoqërinë Administruese, për çdo ndryshim tek të dhënat personale, si dhe të dhënat e kontaktit të tij.

Neni 10

TRANSFERIMI I AKTIVEVE

- 10.1 Anëtarit ka të drejtë që në çdo kohë, të transferojë aktivet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta, ose nga një tjetër Shoqëri Administruese. Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, kryhet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga Anëtarit, dhe nuk shoqërohet me komision transferimi.
- 10.2 Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një fond të një shoqërie tjetër administruese, shoqëria administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtarit për të transferuar aktivet, njofton brenda 5 ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve.
- 10.3 Transferimi i aktiveve në fondin e ri kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë tjetër administruese.
- 10.4 Shoqëria Administruese, brenda 5 ditëve pune nga data e transferimit të llogarisë, informon anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën e aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e zbritura.

Neni 11

PAGESA E PËRFITIMEVE

- 11.1 Anëtarit i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e vet ose pagesat periodike, në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlere:
 - a) kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë anëtar;
 - b) 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar me Ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë Anëtar;
 - c) kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme, dhe që vërtetohet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

- 11.2 Pagesa e menjëherëshme e vlerës neto të aktiveve, do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës;
- 11.3 Anëtari i fondit mund të vendosë të marrë pagesa periodike mujore në formë pensioni të zgjatura në kohë, jo më pak se 2 vjet, në mënyrë që të përfitojë nga regjimi fiskal lehtësues, sipas legjislacionit në fuqi. Pagesat periodike në formë pensioni, do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të veçantë, që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara në Ligj;
- 11.4 Me qëllim përfitimin e pagesës së aktiveve të veta në Fond, Anëtari i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen;
- 11.5 Nëse Anëtari me plotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 11.1, vendos të blejë një kontratë të sigurimit të jetës në formë "anuiteti" nga një shoqëri sigurimi jete, vlera neto e aktiveve në llogarinë e tij do të transferohet te shoqëria e sigurimit të jetës, sipas opsionit të zgjedhur nga anëtari i fondit. Shoqëria administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës, për kërkesën e anëtarit të fondit, dhe merr konfirmimin nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë "anuiteti".

Neni 12

TËRHEQJA E PARAKOHSHME

- 12.1 Anëtari ka të drejtë që të tërheqë aktivet nga llogaria individuale e Fondit ,përpara plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 11 të kontratës. Shoqëria Administruese kryen pagesën e vlerës neto të aktiveve në llogarinë e Anëtarit, brenda 30 ditësh, nga marrja e kërkesës së Anëtarit për tërheqje të parakohshme.
- 12.2 Në rastin e tërheqjes së parakohshme, Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete, të cilat do të llogariten mbi vlerën neto të aktiveve, dhe më konkretisht:
- 2% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
 - 5%për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore, që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
 - 10% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore, që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
 - 15% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore, deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;
- 12.3 Në rastin e vdekjes së Anëtarit, penalteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.

Neni 13

PAGESA E AKTIVEVE NË RASTIN E VDEKJES SË ANËTARIT

Në rastin kur Anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aktiveve të veta, aktivet në llogarinë e tij/saj, u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

Neni 14

KOMISIONET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese do të aplikojë komisionet e mëposhtme :

- a) Komisioni vjetor i administrimit të Fondit do të jetë 1,5 % në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit. Vlera neto e aktiveve, përbëhet nga vlera e përgjithshme e aktiveve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit. Tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet aktiveve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji, si shumë e vlerës ditore për atë muaj.
- b) Komisioni i transferimit do të jetë 0,5% e shumës së transferuar. Ky komision do të aplikohet në rastin e transferimit të aktiveve nga Anëtari në një Fond tjetër të administruar nga një tjetër Shoqëri Administruese.

Çdo rritje e komisioneve që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet Anëtarëve në Fond të paktën 6 muaj përpara hyrjes së tyre në fuqi, sipas legjislacionit në fuqi. Në rast ulje të tyre, njoftimi do të publikohet në faqen zyrtare në web të Shoqërisë Administruese.

Neni 15

TRAJTIMI FISKAL

Trajtimi fiskal i kontributeve të paguara nga Anëtari në Fond, si dhe pagesave të kryera nga Fondi do të jetë sipas dispozitave ligjore në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- 16.1 Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar, dhe do të sjellë pasoja ligjore vetëm pasi të jetë bërë pagesa e parë e kontributit.
- 16.2 Kontrata do të përfundojë :
- a) Nëse Anëtari brenda 30 ditëve kalendarike nga pagesa e kontributit të parë në fond, njofton me shkrim ose postë elektronike, shoqërinë administruese për zgjidhjen e kontratës së anëtarësimit. Në këtë rast, Shoqëria Administruese

brenda 5 ditë pune, do t'i kthejë Anëtarit pa aplikuar penalitet, vlerën e kontributeve të paguara në llogari, përfshirë kthimin nga investimi, përjashtuar tarifën e administrimit për atë periudhë.

- b) Kur të gjitha aktivet e Anëtarit janë transferuar në një tjetër Fond Pensioni;
- c) Në rastin e tërheqjes së parakohshme të të gjitha aktiveve në fond dhe përfundimit të anëtarësimit;
- d) Në rastin e vdekjes së Anëtarit.

Neni 17

KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

17.1 Shoqëria Administruese ruan konfidencialitetin në lidhje me informacionin e dhënë nga Anëtarit, si dhe të dhënat e llogarisë.

17.2 Shoqëria Administruese është e detyruar të raportojë këtë lloj informacioni, vetëm me kërkesë të organeve kompetente, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 18

GJYKATA KOMPETENTE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Neni 19

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

19.1 Ndryshimet në kushtet e kontratës tip, mund të bëhen vetëm me marrëveshje me shkrim midis Palëve, si dhe me miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19.2 Me lidhjen e kësaj kontrate, çdo marrëveshje e mëparshme e lidhur midis palëve shfuqizohet. Të gjitha të drejtat e fituara dhe kontributet e akumuluar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate mbeten të vlefshme dhe do të vijnë në administrim sipas dispozitave të kësaj kontrate dhe Prospektit të Fondit, për sa kohë nuk vijnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

19.3 Kjo kontratë hartohet në dy kopje, nga një për secilën palë.

19.4 Në rastin kur një person i tretë paguan kontribute në emër dhe për llogari të Anëtarit, kontrata do të hartohet në 3 (tre) kopje origjinale nga një për secilën palë, përfshirë edhe personin e tretë që paguan kontribute.